Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Data: 02-918
Ref.: 29.02.19

Në mbështetje të nenit 22 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare, nr. 7 / 01 mars 2019), nenin 17 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive më 22.03.2011, Rregullores nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, Rregullores nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, nenin 11 të Ligjit për Kualifikimet Kombetare si dhe Udhëzimin Administrativ 09/2019 Kriteret Dhe Procedurat Për Akreditimin E Institucioneve Që Zbatojnë Njohjen E Mësimit Paraprak Në Kosovë, Drejtori i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve nxjerr:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

I. Emërohet Komisioni Përzgjedhës për konkursin, të shpallura më: 22.07.2019 me nr.Ref.: JP00039850 pozita: Zyrtar i Lartë Për Njohjen e Mësimit Paraprak.

II. Komisioni do të punojë në këtë përbërje:

1. Lah Nitaj, Kryetar i Komisionit, drejtor i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve;
2. Avni Gashi, Anëtar, u.d. Drejtor i Agjencisë Kosovare e Akreditimit;
3. Ileana Hoxha, anëtar, udhëheqëse për Buxhet dhe Financa, Qendra e Studentëve;
4. Nazan Safqi, anëtar, Udhëheqëse e divizionit për arsim të komuniteteve
5. Adlie Hamiti anëtar, Udhëheqëse për Sektorin për Inspektimin e Brendshëm

III. Komisioni ka përgjegjësinë e vlerësimit të listës së kandidatëve që kanë konkurruar si dhe vlerësimin e rezultateve dhe propozimin e listës përfundimtare përzgjedhëse për kandidatët më të suksesshëm dhe shpërbëhet menjëherë pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes.

IV. Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

V. Vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Lah Nitaj
Drejtor i AKK-s

Vendimi t`u dërgohet:
-Anëtarëve të Komisionit përzgjedhës;
-Arkivit të AKK